



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Zyra e Kryeministrit*  
*Kancelarija Premijera - Office of the Prime Minister*

**Raport mbi zbatimin e Programit Kombëtar për Integrim Evropian  
(PKIE) gjatë periudhës janar - shtator 2024**

**Dhjetor 2024**  
**Prishtinë**

## Përmbajtja

<b>HYRJE</b>	<b>4</b>
<b>0. PASQYRË E PËRGJITHSHME E ZBATIMIT TË PKIE-SË GJATË PERIU DHËS JANAR – SHTATOR 2024</b>	<b>4</b>
0.1. Gjendja sipas blloqeve: Kriteret politike	8
0.2. Gjendja sipas blloqeve: Kriteret ekonomike	8
0.3. Gjendja sipas blloqeve: Standardet evropiane – për afrimi i legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së	10
0.4. Gjendja sipas institucioneve	13
<b>1. BLOKU 1: KRITERET POLITIKE</b>	<b>16</b>
<b>1.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit</b>	<b>16</b>
1.1.1. Kushtetuta, parlamenti dhe sistemi zgjedhor	16
1.1.2. Administrata publike	16
1.1.3. Avokati i Popullit	17
1.1.4. Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë	17
<b>1.2. Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare</b>	<b>17</b>
<b>2. BLOKU 2: KRITERET EKONOMIKE</b>	<b>17</b>
2.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut	18
2.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit	18
<b>3. BLOKU 3: STANDARDET EVROPIANE – PËR AFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË</b>	<b>19</b>
3.0. Korniza ligjore për për afrimin e legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së	19
3.1. Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave	19
3.2. Kapitulli 2: Liria e lëvizjes së punonjësve	20
3.3. Kapitulli 3: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve	20
3.4. Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit	20
3.5. Kapitulli 5: Prokurimi publik	21
3.6. Kapitulli 6: E drejta e kompanive	21
3.7. Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale	23
3.8. Kapitulli 8: Politikat e konkurrencës	23
3.9. Kapitulli 9: Shërbimet financiare	24
3.10. Kapitulli 10: Shoqëria e informacionit dhe mediat	24
3.11. Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural	24
3.12. Kapitulli 12: Politikat e sigurisë së ushqimit, të veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë	25
3.13. Kapitulli 13: Peshkataria	26
3.14. Kapitulli 14: Politikat e transportit	26
3.15. Kapitulli 15: Energjia	27
3.16. Kapitulli 16: Tatimet	28
3.17. Kapitulli 17: Politikat ekonomike dhe monetare	28
3.18. Kapitulli 18: Statistikat	28
3.19. Kapitulli 19: Politikat sociale dhe punësimi	29
3.20. Kapitulli 20: Politikat e ndërmarrjeve dhe ato të industrisë	29
3.21. Kapitulli 21: Rrjetet trans-evropiane	30
3.22. Kapitulli 22: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore	30
3.23. Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore	30
3.24. Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria	31
3.25. Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimet shkencore	32
3.26. Kapitulli 26: Arsimit dhe kultura	33
3.27. Kapitulli 27: Mjedisi	34
3.28. Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit	35

3.29. Kapitulli 29: Unioni Doganor .....	35
3.30. Kapitulli 30: Marrëdhëniet me jashtë .....	36
3.31. Kapitulli 31: Politika e jashtme, e sigurisë dhe ajo e mbrojtjes .....	36
3.32. Kapitulli 32: Kontrolli financiar .....	37
3.33. Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe ato buxhetore .....	37
<i>Shtojcë: Pasqyrë e zbatimit të PKIE gjatë vitit 2024 – gjendja në fund të tremujorit të tretë .....</i>	<i>38</i>

## HYRJE

Programi Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2024 – 2028 është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 5 prill 2024 dhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 30 tetor 2024. Ai është dokument ligjërish i detyrueshëm për të gjitha organet e administratës shtetërore, të cilat obligohen të zbatojnë masat afatshkurtra nën përgjegjësinë e tyre. Qeveria, si mekanizmi qendror nacional përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së dhe kriterëve të tjera për integrim në Bashkimin Evropian (BE), mbikëqyr zbatimin e PKIE-së përmes institucionit kryesor për koordinimin e këtij procesi – Zyrës së Kryeministrit (ZKM). ZKM, përmes departamenteve përgjegjëse për integrim evropian, monitoron zbatimin e PKIE-së në baza tremujore, përmes raporteve të rregullta. Këto raporte shërbejnë për të vlerësuar dhe përmirësuar zbatimin e tij dhe për llogaridhënie e transparencë brenda institucioneve dhe ndaj palëve të tjera të interesuara e publikut të gjerë. Gjetjet, ndër të tjera, diskutohen nga kabineti i Qeverisë dhe nga organet e stabilizim-asociimit BE – Kosovë përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të MSA-së.

Ky është raporti i parë për vitin 2024 dhe mbulon periudhën 1 janar – 30 shtator. Të dhënat janë raportuar nga institucionet përgjegjëse përmes *Platformës online për monitorim dhe raportim për integrim evropian*, sipas udhëzuesit përkatës. Në kapitujt ku të dhënat janë raportuar me vonesë ose në mënyrë joadekuate, ato nuk janë përfshirë në raport dhe masat përkatëse janë vlerësuar si të pazbatuara plotësisht, ose që përballen me vonesa serioze. Zbatimi i programit është vlerësuar sipas statusit të ecurisë (paraqitur në diagrame) për të gjitha masat dhe për ato të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë. Zbatimi i të gjitha masave është vlerësuar sipas pesë niveleve të statusit të ecurisë:

- Masat *e zbatuara* (ato që janë zbatuar plotësisht) – me **të kaltër**;
- Masat *në zbatim e sipër*, pa vonesa (ato që kanë filluar së zbatuari dhe pritet të zbatohen në tërësi brenda afateve të parapara) – me **të gjelbër**;
- Masat që përballen me *pak vonesa* (ato që kanë filluar së zbatuari, por përballen me pak vonesa e probleme) – me **të verdhë**;
- Masat që përballen me *vonesa serioze* (ato që janë paraparë të zbatohen gjatë periudhës raportuese, por që akoma nuk janë zbatuar plotësisht në fund të kësaj periudhe, apo/ dhe përballen me vonesa e probleme serioze) – me **të kuqe**; dhe
- Masat e planifikuara për t'u zbatuar *në të ardhmen* (ato që akoma nuk kanë filluar së zbatuari dhe janë planifikuar të zbatohen në pjesën e mbetur të vitit) – me **të hirtë**.

Zbatimi i masave të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë është vlerësuar sipas dy niveleve të statusit të ecurisë:

- Masat *e zbatuara* – me **të kaltër**; dhe
- Masat që përballen me *vonesa serioze* – me **të kuqe**.

Ky raport përmban katër kapituj dhe ndahet në dy pjesë: pjesa mbi Programin në tërësi dhe ajo mbi secilin bllok. Kapitulli 0 jep një pasqyrë të përgjithshme mbi gjendjen deri në fund të shtatorit në zbatimin e Programit në tërësi, në raport me tërë vitin dhe gjatë tremujorit më të fundit. Ky kapitull është i ndarë në pesë pjesë: pjesa mbi Programin në tërësi, pjesa mbi kriteret politike, pjesa mbi kriteret ekonomike, pjesa mbi standardet evropiane, dhe pjesa sipas institucioneve. Secila pjesë përmban diagramin dhe pjesën narrative (shpjegimin e gjetjeve).

Pjesa narrative mbi secilin bllok përmbillet me listën e masave që nuk janë zbatuar gjatë periudhës raportuese dhe ato që pritet të përballen me sfida gjatë periudhës në vijim. Kapitujt 1, 2 dhe 3 janë uniformë – secili përmban nga dy pjesë për secilin kapitull: diagramin dhe pjesën narrative. Diagramet paraqesin gjetjet mbi zbatimin e kapitullit, ndërsa pjesa narrative jep një përmbledhje të tyre dhe të gjendjes së përgjithshme në kapitull. Gjendja e zbatimit të kapitullit përkatës vlerësohet në dy nivele: *deri në fund të periudhës raportuese* (në raport me të gjitha masat e planifikuara në kuadër të tij) dhe *gjatë tremujorit më të fundit* (për masat e planifikuara për t'u zbatuar brenda tremujorit të tretë). Raporti gjithashtu përmban shtojcën, e cila paraqet gjendjen e zbatimit të të gjitha masave deri në fund të periudhës raportuese.


Gjetjet tregojnë se *gjatë tremujorit të tretë* të këtij viti *Programi* është zbatuar në nivel prej **30.95%: 13 nga 42 masa** të planifikuara për këtë tremujor janë zbatuar, ndërsa 69.05% e tyre, 29 masa, akoma nuk janë

zbatuar plotësisht (diagrami 0.2, fq. 6). Për më tepër, *deri në fund të tremujorit të tretë* është zbatuar **27.84% e tërë Programit, përkatësisht 76 nga 306 masa** të planifikuara, ndërsa 75.16% e tyre (230 masa) akoma nuk janë zbatuar plotësisht (diagrami 0.1, fq. 6).

## 0. PASQYRË E PËRGJITHSHME E ZBATIMIT TË PKIE-SË GJATË PERIUdhËS JANAR – SHtATOR 2024

Programi përmban 306 masa: 105 (34.31%) masa legjislative dhe 201 (65.69%) masa zbatuese.

Diagrami 0.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të programit deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 24.83% e masave, 76 masa, janë zbatuar;
- 39.87% e masave, 122 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 9.48% e masave, 29 masa, përballen me pak vonesa;
- 25.49% e masave, 78 masa, përballen me vonesa serioze;
- 0.33% e masave, 1 masë, janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit në vijim.

Nga të gjitha masat e programit (306), 42 (13.72%) prej tyre, ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë: 19 masa legjislative dhe 23 masa zbatuese.

Diagrami 0.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: masat e planifikuara për tremujorin e tretë




Sa i përket zbatimit të masave të programit të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 30.95% e masave, 13 masa, janë zbatuar;
- 69.05% e masave, 29 masa, akoma nuk janë zbatuar, pra përballen me vonesa serioze.

Nga të gjitha masat e programit (306), 105 (34.31%) prej tyre janë masa legjislative.

Diagrami 0.3. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: të gjitha masat legjislative




Sa i përket zbatimit të masave legjislative të programit deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 29.52% e masave, 31 masa, janë zbatuar;
- 13.33% e masave, 14 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 14.29% e masave, 15 masa, përballen me pak vonesa;

- 42.86% e masave, 45 masa, përballen me vonesa serioze.

Nga të gjitha masat legjislative të programit (105), 19 (18.1%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 0.4. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: masat legjislative të planifikuara për tremujorin e tretë




Sa i përket zbatimit të masave legjislative të programit të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 42.11% e masave, 8 masa, janë zbatuar;
- 57.89% e masave, 11 masa, akoma nuk janë zbatuar, pra përballen me vonesa serioze.

Nga të gjitha masat e programit (306), 201 (65.69%) prej tyre janë masa zbatuese.

Diagrami 0.5. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: të gjitha masat zbatuese




Sa i përket zbatimit të masave zbatuese të programit deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 22.39% e masave, 45 masa, janë zbatuar;
- 53.73% e masave, 108 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 6.97% e masave, 14 masa, përballen me pak vonesa;
- 16.42% e masave, 33 masa, përballen me vonesa serioze;
- 0.5% e masave, 1 masë, janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit në vijim.

Nga të gjitha masat zbatuese të programit (201), 23 (11.44%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 0.6. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: masat zbatuese të planifikuara për tremujorin e tretë




Sa i përket zbatimit të masave zbatuese të programit të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 21.74% e masave, 5 masa, janë zbatuar;
- 78.26% e masave, 18 masa, akoma nuk janë zbatuar, pra përballen me vonesa serioze.

### 0.1. Gjendja sipas blloqeve: Kriteret politike

Ky bllok përmban 19 masa: 7 (36.84%) masa legislative dhe 12 (63.16%) masa zbatuese.

Diagrami 0.1.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Kriteret politike – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të këtij blloku deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 36.84% e masave, 7masa, janë zbatuar;
- 26.32% e masave, 5 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 31.58% e masave, 6 masa, përballen me vonesa serioze;
- 5.26% e masave, 1 masë, janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit në vijim.

Nga të gjitha masat e këtij blloku (19), 1 masë zbatuese (5.26%) ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 0.1.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Kriteret politike – masat e planifikuara për tremujorin e tretë



Sa i përket zbatimit të masave të këtij blloku të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar akoma nuk është zbatuar, pra përballen me vonesa serioze.

Bazuar në gjetjet e këtij raporti, masat e këtij blloku që pritet të përballen me sfida e vonesa dhe që kërkojnë vëmendje në pjesën e mbetur të vitit janë si në vijim:

- Miratimi nga Qeveria i projektligjit për plotësim-ndryshim të ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimi i tyre me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative – faza e tretë;
- Miratimi nga Qeveria i projektligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura;
- Miratimi i UA për zbatimin e Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës;
- Miratimi i UA për zbatimin e Ligjit për Shqyrtim Administrativ të Akteve;
- Vlerësimi ex-post i Ligjit për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës – Prishtinën;
- Miratimi i katalogut i vendeve të punës në Shërbimin Civil.


### 0.2. Gjendja sipas blloqeve: Kriteret ekonomike

Ky bllok përmban 5 masa zbatuese.





Diagrami 0.2.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Kriteret ekonomike – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij blloku deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 40% e masave, 2 masa, janë zbatuar;
- 60% e masave, 3 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa.

Nga të gjitha masat e këtij blloku (5), 1 (20%) prej tyre ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 0.2.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Kriteret ekonomike – masat e planifikuara për tremujorin e tretë




Sa i përket zbatimit të masave të këtij blloku të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar është zbatuar.

### 0.3. Gjendja sipas blloqeve: Standardet evropiane – përafrimi i legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së

Ky bllok përmban 282 masa: 98 (34.75%) masa legislative dhe 184 (65.25%) masa zbatuese.

Diagrami 0.3.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Standardet evropiane – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të këtij blloku deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 23.4% e masave, 66 masa, janë zbatuar;
- 40.79% e masave, 115 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 10.28% e masave, 29 masa, përballen me pak vonesa;
- 25.53% e masave, 72 masa, përballen me vonesa serioze.

Nga të gjitha masat e këtij blloku (282), 40 (14.18%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë: 19 masa legislative dhe 21 masa zbatuese.

Diagrami 0.3.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Standardet evropiane – masat e planifikuara për tremujorin e tretë



Sa i përket zbatimit të masave të këtij blloku të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 31.58% e masave, 12 masa, janë zbatuar;
- 68.42% e masave, 26 masa, akoma nuk janë zbatuar, pra përballen me vonesa serioze.

Bazuar në gjetjet e këtij raporti, masat e këtij blloku që pritet të përballen me sfida e vonesa dhe që kërkojnë vëmendje në pjesën e mbetur të vitit janë si në vijim:

- Miratimi nga Qeveria i projektligjit për inspektimin e përputhshmërisë së produkteve;
- Miratimi nga Qeveria i dy projektligjeve në kapitullin e prokurimit publik: PL për prokurimin publik (plotësim-ndryshim) dhe PL për partneritetin publiko-privat (plotësim-ndryshim);
- Miratimi nga Qeveria i projektligjit për ndihmën shtetërore (plotësim-ndryshim);
- Miratimi nga Qeveria i projektligjit për komunikimet elektronike;
- Miratimi nga Qeveria i dy projektligjeve në kapitullin e bujqësisë dhe zhvillimit rural: PL për agroturizëm dhe PL për tokën bujqësore;
- Miratimi nga Qeveria i projektligjit për veterinarinë;
- Miratimi nga Qeveria i projektligjit për peshkatarinë dhe akua-kulturën;
- Miratimi nga Qeveria i pesë projektligjeve në kapitullin e politikave të transportit: PL për automjete, PL për hekurudha, PL për transportin rrugor, PL për transportin e mallrave të rrezikshme, dhe PL për siguri hekurudhore;
- Miratimi nga Qeveria i katër projektligjeve në kapitullin e energjisë: PL për energji, PL për energjinë elektrike, PL për rregullatorin e energjisë, dhe PL për eficiencën e energjisë;
- Miratimi nga Qeveria i dy projektligjeve në kapitullin e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë: PL për të drejtën në gjykim brenda kohës së arsyeshme dhe PL për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve (plotësim-ndryshim);
- Nënshkrimi i marrëveshjes për bashkëpunim juridik me Francën;
- Miratimi nga Qeveria i projektligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Armë;
- Miratimi nga Qeveria i projektligjit për veprimtari kërkimore shkencore, inovacion dhe transfer të dijes dhe teknologjisë;
- Miratimi nga Qeveria i tre projektligjeve në kapitullin e mjedisit: PL për mbrojtjen e mjedisit, PL për mbrojtjen e natyrës, dhe PL për inspektimin në fushën e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe banimit;
- Miratimi nga Qeveria i dy projektligjeve në kapitullin e mbrojtjes së konsumatorit dhe të shëndetit: PL për pajisje dhe produkte medicinale dhe PL për kontrollin e duhanit;
- Miratimi nga Qeveria i projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës (plotësim-ndryshim);
- Miratimi i dy akteve nënligjore në kapitullin e lëvizjes së lirë të mallrave: UA për shkëmbimin e informacionit për produktet e rrezikshme në Kosovë dhe UA për përcaktimin e rregullave për lëvizjen e lirë në treg të detergjenteve dhe substancave tension-aktive (surfaktantive);
- Miratimi i dy akteve nënligjore në kapitullin e lëvizjes së lirë të kapitalit: UA për sanksionet e shënjestruara (udhëzuesit për zbatimin e sanksioneve nga subjektet raportuese dhe personat që kanë detyrime për raportim të drejtpërdrejtë dhe UA për sanksionet e shënjestruara (udhëzuesit për zbatimin e sanksioneve ndaj autoriteteve shtetërore);

- *Miratimi i rregullores për procedurat e kriteret e licencimit të shoqatave për menaxhim kolektiv dhe funksionimin e tyre;*
- *Miratimi i dy rregulloreve në kapitullin e konkurrencës: rregullores për procedurat dhe format e njoftimit të ndihmës shtetërore (plotësim-ndryshim) dhe rregullores për kushtet e dhënies së ndihmës sektoriale;*
- *Miratimi i dy rregulloreve në kapitullin e shërbimeve financiare: rregullores për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së likuiditetit (ILAAP) dhe rregullores për ekspozimet e mëdha të bankave (plotësim-ndryshim);*
- *Miratimi i tre UA-ve në kapitullin e bujqësisë dhe zhvillimit rural: UA për sistemin e informacionit për çmimet e tregut, UA për kontabilitetin në fermë dhe UA për kriteret dhe procedurat e zbatimit për masat e programit të zhvillimit rural;*
- *Miratimi i dy UA-ve në kapitullin e politikave të sigurisë së ushqimit, të veterinarisë dhe atyre të fitosanitarisë: UA për luftimin e sëmundjes infektive zoonotike-tërbimit dhe UA për luftimin e sëmundjes zoonotike të shpezëve-gripi i shpezëve (avian influ-enza);*
- *Miratimi i tri rregulloreve në kapitullin e politikave të transportit: rregullores për specifikimet teknike për interoperabilitet në lidhje me sigurinë në tunelet hekurudhore (STI SRT), rregullores për autorizim të nënsistemeve strukturore, dhe rregullores për regjistrimin e infrastrukturës (plotësim-ndryshim);*
- *Miratimi i dy UA-ve në kapitullin e energjisë: UA për caqet dhe trajektoren kombëtare për energjinë nga burimet e ripërtëritshme dhe UA për dizajnimin dhe përcaktimin e procedurës së procesit konkurrues të tenderimit;*
- *Miratimi i dy UA-ve në kapitullin e gjyqësorit dhe të të drejtave themelore: UA (masë afirmative) për rritjen e numrit të grave në pozita vendimmarrëse - niveli ekzekutiv dhe UA (masë afirmative) për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve;*
- *Miratimi i UA për koordinimin ndër sektorial për zhvillimin e edukimit në fëmijërinë e hershme;*
- *Miratimi i UA për mekanizmin e përcjelljes së emisioneve të gazrave serë (plotësim-ndryshim);*
- *Miratimi i tre UA-ve në kapitullin e mbrojtjes së konsumatorit dhe të shëndetit: UA mbi kërkesat e përcaktuara në relacion me komunikimin tregtar, përfshirë reklamimin apo marketingun, UA për kriteret, procedurat, masat e biosigurisë dhe biosigurimit për transportin e mostrave për qëllime diagnostike të sëmundjeve ngjitëse, dhe UA për ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale për rastet e mundshme, të dyshimta dhe të konfirmuara nga sëmundjet ngjitëse dhe çështjet e veçanta shëndetësore;*
- *Miratimi i rregullores për integrimin e të huajve (plotësim-ndryshim);*
- *Miratimi i koncept dokumenti për fushën e akreditimit;*
- *Miratimi i Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Autorit 2024–2028;*
- *Miratimi i Strategjisë për Teknologjinë e Informimit dhe të Komunikimit (TIK);*
- *Miratimi i planit për avancimin e ndërmarrjeve agro-ushqimore;*
- *Miratimi i koncept dokumenti për sëmundjet e kafshëve;*
- *Miratimi i PV të Strategjisë së Sistemit Inteligent të Transportit (ITS);*
- *Miratimi i Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK) 2024-2030;*
- *Miratimi i PV të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGj) 2024-2026;*
- *Miratimi i katër dokumenteve të politikave në kapitullin e gjyqësorit dhe të të drejtave themelore: Strategjisë dhe PV për Sundimin e Ligjit (rishikim), Strategjisë dhe PV kundër Korrupsionit, Strategjisë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2024-2029 dhe koncept dokumentit për trashëgimi kulturore;*
- *Miratimi i dokumenteve në kapitullin e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë: planit të reagimit emergjent (rishikim) dhe PSO-ve për shkatërrimin e drogave;*
- *Miratimi i Kornizës Kurrikulare për Arsim dhe Aftësim Profesional (AAP);*
- *Miratimi i dy dokumenteve të politikave në kapitullin e mbrojtjes së konsumatorit dhe të shëndetit: koncept dokumentit për transplantim të organeve dhe planit strategjik për kontrollin e kancerit;*
- *Miratimi i tre dokumenteve të politikave në kapitullin e mjedisit: Strategjisë dhe PV për Mbrojtje të Mjedisit dhe Zhvillim të Qëndrueshëm 2025-2034, strategjisë afatgjate të dekarbonizimit dhe Strategjisë dhe PV për Menaxhimin e Integruar të Mbeturisë 2024-2026;*
- *Rekrutimi i së paku pesë (5) zyrtarëve të rinj në Agjencinë e Metrologjisë;*
- *Funksionalizimi i Ueb-faqes për Pikën e Vetme të Kontaktit për Shërbime;*

- Rekrutimi i së paku pesë (5) zyrtarëve në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP);
- Themelimi i Agjencisë për Inovacion dhe Mbështetjen e Bizneseve;
- Zhvillimi i platformës elektronike për raportim të korrupsionit “Kosova pa Korrupsion”;
- Zhvillimi i aplikacionit për raportim online për regjistrin e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve;
- Ngritja e kapaciteteve institucionale në kapitullin e gjyqësorit dhe të të drejtave themelore: emërimi i një (1) anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), rekrutimi i shtatë (7) zyrtarëve të ndërmjetësimit në Prokuroritë Themelore, rekrutimi i trembëdhjetë (13) zyrtarëve të rinj në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (APK) dhe rekrutimi i dy (2) zyrtarëve të TI-së në APK;
- Ngritja e kapaciteteve institucionale në kapitullin e arsimit dhe kulturës: rekrutimi i së paku njëzet (20) inspektorëve të rinj të arsimit, dhe rekrutimi i së paku njëqind (100) asistentëve, për të përmirësuar qasjen në arsim të fëmijëve me nevoja të veçanta;
- Rekrutimi i zyrtarëve të rinj doganorë;
- Publikimi i tipologjive të pastrimit të parave për personat e ekspozuar politikisht;
- Miratimi i metodologjisë për inspektimin e auditorëve ligjorë dhe firmave ligjore të auditimit;
- Mbajtja e së paku tre (3) aktiviteteve me palët e interesit për Pikën e Vetme të Kontaktit për Shërbime;
- Mbajtja e së paku tre (3) trajnimeve për stafin e OShP-së (për procedurat e shqyrtimit administrativ; administrimin e punëve në zyre; si dhe për rregullat për menaxhimin e financave publike, regjistrat e pasurive dhe raportimin vjetor nga organizatat buxhetore);
- Avancimi i bazës së të dhënave që mundëson ndërlidhje me sistemin e BE-së për Ndërlidhjen e Regjistrave të Bizneseve (BRIS);
- Zbatimi i udhërrëfyesit të transpozimit të Solvency 2;
- Inventarizimi i resurseve peshkore në pellgjet ujore;
- Zbatimi i masave të efikasitetit të energjisë në ndërtesat publike në nivelin komunal: 8 objekte shkollore në 4 komuna (Prishtinë, Gjilan, Gjakovë dhe Ferizaj), dhe në 29 ndërtesa shumë-banesore sociale e shtëpi individuale;
- Mbledhja e të dhënave nga anketa në teren në kuadër të Anketës së Strukturës së të Ardhurave (ASA/SES);
- Monitorimi i zbatimit të veprimeve nga Strategjia dhe PV kundër Korrupsionit;
- Zbatimi i Udhërrëfyesit për Armë të Vogla dhe të Lehta.


#### 0.4. Gjendja sipas institucioneve

Kjo pjesë jep një pasqyrë të gjendjes së zbatimit të Programit sipas institucioneve të cilat kanë planifikuar të zbatojnë masa gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024. Me qëllim të vlerësimit të performancës së tyre, institucionet janë ranguar sipas përqindjes së masave që kanë zbatuar.

Të gjitha masat e programit (306) bien nën përgjegjësinë e 26 institucioneve: 16 institucioneve të Qeverisë dhe 10 institucioneve të tjera.

Të gjitha masat e planifikuara për t’u zbatuar gjatë tremujorit të tretë (42) bien nën përgjegjësinë e 12 institucioneve: 9 institucioneve të Qeverisë dhe 3 institucioneve të tjera. Nga të gjitha masat e planifikuara për t’u zbatuar gjatë kësaj periudhe (42), 30 (71.43%) prej tyre bien nën përgjegjësinë e institucioneve të Qeverisë, përkatësisht të 9 institucioneve të saj.


Diagrami 0.4.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: performanca e Qeverisë në tërësi gjatë tremujorit të tretë



Sa i përket performancës së Qeverisë në tërësi zbatimin e masave nën përgjegjësinë e saj të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 16.67% e masave, 5 masa, janë zbatuar;
- 83.33% e masave, 25 masa, akoma nuk janë zbatuar, pra përballen me vonesa serioze.

Diagrami 0.4.1.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: performanca e secilit institucion të Qeverisë gjatë tremujorit të tretë




Sa i përket performancës së secilit institucion të Qeverisë të cilët kanë planifikuar të zbatojnë masa gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, gjetjet tregojnë si në vijim:

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) – 50% (3 / 6 masa të zbatuara);
- Ministria e Drejtësisë (MD) – 33.33% (1 / 3 masa të zbatuara);
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) – 20% (1 / 5 masa të zbatuara);
- Ministria e Shëndetësisë (MSh) – 0% (0 / 6 masa të zbatuara);
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) – 0% (0 / 5 masa të zbatuara);
- Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) – 0% (0 / 2 masa të zbatuara);
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) – 0% (0 / 1 masa të zbatuara);
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) – 0% (0 / 1 masa të zbatuara);
- Zyra e Kryeministrit (ZKM) – 0% (0 / 1 masa të zbatuara).

Nga të gjitha masat e planifikuara për t'u zbatuar gjatë kësaj periudhe (42), 12 (28.57%) prej tyre bien nën përgjegjësinë e institucioneve të tjera, përkatësisht të 3 institucioneve të kësaj kategorie.

Diagrami 0.4.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: performanca e institucioneve të tjera gjatë tremujorit të tretë



Sa i përket performancës së secilit prej institucioneve të tjera të cilët kanë planifikuar të zbatojnë masa gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, gjetjet tregojnë si në vijim:

- Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) – 100% (7 / 7 masa të zbatuara);
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) – 25% (1 / 4 masa të zbatuara);
- Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) – 0% (0 / 1 masa të zbatuara).

## 1. BLOKU 1: KRITERET POLITIKE

### 1.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit


#### 1.1.1. Kushtetuta, parlamenti dhe sistemi zgjedhor

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

#### 1.1.2. Administrata publike

Ky kapitull përmban 15 masa: 7 (47%) masa legislative dhe 8 (53%) masa zbatuese.

Diagrami 1.1.2.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar - shtator 2024: Administrata publike – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 46.67% e masave, 7 masa, janë zbatuar;
- 13.33% e masave, 2 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 40% e masave, 6 masa, përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
  - Miratimi nga Qeveria i projektligjit për plotësim-ndryshim të ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimi i tyre me ligjin për procedurën e përgjithshme administrative;
  - Miratimi nga Qeveria i projektligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura;
  - Miratimi i UA për zbatimin e Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës;
  - Miratimi i UA për zbatimin e Ligjit për Shqyrtim Administrativ të Akteve'
  - Hartimi dhe publikimi i vlerësimit ex-post të Ligjit për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën;
  - Miratimi i Katalogut të vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (15), 1 masë zbatuese (6.67%) ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 0.1.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar - shtator 2024: Administrata publike – masat e planifikuara për tremujorin e tretë



Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar akoma nuk është zbatuar, pra përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, në këtë kapitull vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet zbatimit të masave legislative të planifikuara, pasi që projektligjet janë akoma në fazën e drafteve. Për shkak të vonesave në miratimin e projektligjeve, aktet nënljigjore që bien nën përgjegjësinë e MAPL-së nuk do të arrijnë të miratohen brenda afateve të planifikuara. Sa u përket akteve nënljigjore nën përgjegjësinë e MPB-së, që rrjedhin nga Ligji për Zyrtarët Publikë, ato janë miratuar




brenda afateve kohore. Më tej, katalogu i vendeve të punës është finalizuar në fund të periudhës raportuese dhe pritej të miratohej së shpejti. Masat për ngritjen e kapaciteteve janë zbatuar sipas planit. Në përgjithësi, masat e këtij kapitulli janë duke u zbatuar sipas planit, me mundësi që të zbatohen plotësisht deri në fund të vitit.

### 1.1.3. Avokati i Popullit

Ky kapitull përmban 2 masa, të gjitha zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 1.1.2.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar - shtator 2024: Avokati i Popullit – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 50% e masave, 1 masë, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 50% e masave, 1 masë, janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit të fundit të vitit.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, të gjitha masat e këtij kapitulli, që kanë të bëjnë me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, janë planifikuar të zbatohen deri në fund të vitit. Ato janë në zbatim e sipër dhe të dhënat përfundimtare do të raportohen në tremujorin e fundit të vitit.


### 1.1.4. Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

### 1.2. Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare

Ky kapitull përmban 2 masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 1.1.2.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar - shtator 2024: Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 2 masa të planifikuara janë në zbatim e sipër, pa vonesa.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, masat e planifikuara në këtë kapitull janë duke u zbatuar sipas planit. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka marrë pjesë në seminare dhe trajnime që ndërliken me përfshirjen e vendit në iniciativa rajonale dhe procesin e integritimit evropian. Përveç kësaj, në kuadër të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore janë zhvilluar takime dhe forume me homologë nga vendet anëtare të kësaj nisme rajonale.

## 2. BLOKU 2: KRITERET EKONOMIKE

### 2.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut

Ky kapitull përmban 5 masa zbatuese.

Diagrami 2.1.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 60% e masave, 3 masa, janë zbatuar;
- 40% e masave, 2 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa.

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (5), 1 masë (20%) ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 2.1.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut – masat e planifikuara për tremujorin e tretë



Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar është zbatuar.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, në këtë kapitull janë arritur rezultate, pra të gjitha masat e planifikuara janë zbatuar brenda afateve. Këto masa janë: hartimi i një analize që lidhet me rreziqet fiskale, si dhe i raportit gjashtëmujor dhe atij vjetor për zbatimin e Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike.

### 2.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

### 3. BLOKU 3: STANDARDET EVROPIANE – PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË


#### 3.0. Korniza ligjore për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

#### 3.1. Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave

Ky kapitull përmban 11 masa: 4 (36.36%) masa legjislative dhe 7 (63.64%) masa zbatuese.

Diagrami 3.1.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Lëvizja e lirë e mallrave – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 18.18% e masave, 2 masa, janë zbatuar;
- 36.36% e masave, 4 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 18.18% e masave, 2 masa, përballen me pak vonesa. Këto masa janë si në vijim:
  - Miratimi nga Qeveria i projektligjit për inspektimin e përputhshmërisë së produkteve;
  - Miratimi i UA për përcaktimin e rregullave për lëvizjen e lirë në treg të detergjenteve dhe substancave tension-aktive (surfaktantive);
- 27.27% e masave, 3 masa, përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
  - Miratimi i UA për shkëmbimin e informacionit për produktet e rrezikshme në Republikën e Kosovës;
  - Miratimi i koncept dokumentit për fushën e akreditimit;
  - Rekrutimi i së paku pesë (5) zyrtarëve të rinj në Agjencinë e Metrologjisë.

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (11), 3 (27.27%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë: 1 masë legjislative dhe 2 masa zbatuese.

Diagrami 3.1.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Lëvizja e lirë e mallrave – masat e planifikuara për tremujorin e tretë



Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 3 masat e planifikuara nuk janë zbatuar, pra përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, asnjë nga masat e planifikuara për tremujorin më të fundit nuk është zbatuar. Këto masa janë: miratimi i UA për shkëmbimin e informacionit për produktet e rrezikshme, miratimi i KD për fushën e akreditimit, dhe rekrutimi i pesë (5) zyrtarëve të rinj në Agjencinë e Metrologjisë.


### 3.2. Kapitulli 2: Liria e lëvizjes së punonjësve

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

### 3.3. Kapitulli 3: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve

Ky kapitull përmban 3 masa zbatuese.

Diagrami 3.3.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 33.34% e masave, 1 masë, është në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 33.33% e masave, 1 masë, përballen me pak vonesa. Kjo masë është si në vijim:
  - Mbajtja e së paku tri (3) aktiviteteve me palët e interesit për Pikën e Vetme të Kontaktit për Shërbime, me qëllim të ngritjes së vetëdijes rreth saj;
- 33.33% e masave, 1 masë, përballen me vonesa serioze. Kjo masë është si në vijim:
  - Lansimi i ueb-faqes për Pikën e Vetme të Kontaktit për Shërbime.

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (3), 1 masë (33.33%) ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.3.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve – masat e planifikuara për tremujorin e tretë



Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar akoma nuk është zbatuar, pra përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, masa e planifikuar për tremujorin më të fundit nuk është zbatuar. Kjo masë është lansimi i ueb-faqes së Pikës së Vetme të Kontaktit për Shërbime.

### 3.4. Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit

Ky kapitull përmban 4 masa: 2 (50%) masa legislative dhe 2 (50%) masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.4.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Lëvizja e lirë e kapitalit – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:


- 25% e masave, 1 masë, është në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 75% e masave, 3 masa, përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
  - Miratimi i UA për sanksionet e shënjestruara (udhëzuesit për zbatimin e sanksioneve nga subjektet raportuese dhe personat që kanë detyrime për raportim të drejtpërdrejtë);
  - Miratimi i UA për sanksionet e shënjestruara (udhëzuesit për zbatimin e sanksioneve ndaj autoriteteve shtetërore),
  - Hartimi dhe publikimi i tipologjive të pastrimit të parave nga personat e ekspozuar politikisht (PEP) me qëllim të zvogëlimit të riskut të pastrimit të parave nga korrupsioni.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky kapitull përballlet me vonesa serioze në përgjithësi, pasi që deri në fund të periudhës raportuese nuk është zbatuar asnjëra nga masat e planifikuara.

### 3.5. Kapitulli 5: Prokurimi publik

Ky kapitull përmban 4 masa: 2 (50%) masa legjislative dhe 2 (50%) masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.5.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Prokurimi publik – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 25% e masave, 1 masë, përballen me pak vonesa. Kjo masë është si në vijim:
  - Mbajtja e së paku tre (3) trajnimeve për stafin e OShP-së (për procedurat e shqyrtimit administrativ, administrimin e punëve në zyre, si dhe për rregullat për menaxhimin e financave publike, regjistrat e pasurive dhe raportimin vjetor nga organizatat buxhetore);
- 75% e masave, 3 masa, përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
  - Miratimi nga Qeveria i projektligjit për prokurim publik (plotësim-ndryshim);
  - Miratimi nga Qeveria i projektligjit për partneritetin publiko-privat (plotësim-ndryshim);
  - Rekrutimi i së paku pesë (5) zyrtarëve të rinj në OShP.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky kapitull përballlet me vonesa serioze në përgjithësi, pasi që deri në fund të periudhës raportuese nuk është zbatuar asnjëra nga masat e planifikuara.

### 3.6. Kapitulli 6: E drejta e kompanive

Ky kapitull përmban 6 masa: 2 (33.33%) masa legjislative dhe 4 (66.67%) masa zbatuese.

Diagrami 3.6.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: E drejta e kompanive – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 16.67% e masave, 1 masë, është zbatuar;
- 50% e masave, 3 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;

- 16.67% e masave, 1 masë, përballen me pak vonesa. Kjo masë është si në vijim:
  - *Avancimi i bazës së të dhënave që mundëson ndërlidhjen me sistemin e BE-së BRIS.*
- 16.66% e masave, 1 masë, përballen me vonesa serioze. Kjo masë është si në vijim:
  - *Hartimi i metodologjisë për inspektimin e auditorëve ligjor dhe firmave ligjore të auditimit.*

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (6), 1 masë zbatuese (16.67%) ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

*Diagrami 3.6.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: E drejta e kompanive – masat e planifikuara për tremujorin e tretë*



Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t’u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar akoma nuk është zbatuar, pra përballlet me vonesa serioze.

*Siç tregojnë gjetjet e raportit, masa e këtij kapitulli e planifikuar për t’u zbatuar deri në fund të periudhës raportuese nuk është zbatuar brenda këtij afati, dhe përballlet me vonesa serioze. Kjo masë është hartimi i metodologjisë për inspektimin e auditorëve ligjorë dhe firmave ligjore të auditimit.*

### 3.7. Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale

Ky kapitull përmban 4 masa: 1 (25%) masë legjislative dhe 3 (75%) masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.7.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: E drejta e pronësisë intelektuale – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 25% e masave, 1 masë, është zbatuar;
- 25% e masave, 1 masë, është në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 25% e masave, 1 masë, përballen me pak vonesa. Kjo masë është si në vijim:
  - *Miratimi i strategjisë kombëtare për të drejtat e autorit 2024 – 2028;*
- 25% e masave, 1 masë, përballen me vonesa serioze. Kjo masë është si në vijim:
  - *Miratimi i rregullores për procedura, kriteret e licencimit të shoqatave për menaxhim kolektiv dhe funksionimin e tyre.*

Siç tregojnë gjetjet e raportit, në këtë kapitull ka pasur zhvillime pozitive gjatë periudhës që mbulon ky raport. Konkretisht, një masë është zbatuar para kohe, një tjetër është duke u zbatuar pa vonesa dhe një përballlet me pak vonesa. Masa që përballlet me vonesa serioze nuk pritet të zbatohet brenda këtij viti.

### 3.8. Kapitulli 8: Politikat e konkurrencës

Ky kapitull përmban 5 masa: 4 (80%) masa legjislative dhe 1 (20%) masa zbatuese.

Diagrami 3.8.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Politikat e konkurrencës – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 40% e masave, 2 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 40% e masave, 2 masa, përballen me pak vonesa. Këto masa janë si në vijim:
  - *Miratimi i rregullores për procedurat dhe format e njoftimit (plotësim-ndryshim);*
  - *Miratimi i rregullores për kushtet e dhënies së ndihmës sektoriale;*
- 20% e masave, 1 masë, përballen me vonesa serioze. Kjo masë është si në vijim:
  - *Miratimi nga Qeveria i projektligjit për ndihmë shtetërore (plotësim-ndryshim).*

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (5), 1 masë legjislative (20%) ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.8.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Politikat e konkurrencës – masat e planifikuara për tremujorin e tretë



Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t’u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar akoma nuk është zbatuar, pra përballlet me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, gjatë tremujorit më të fundit nuk është zbatuar një masë e planifikuar. Kjo masë është miratimi nga Qeveria i projektligjit për ndihmën shtetërore (plotësim-ndryshim).


### 3.9. Kapitulli 9: Shërbimet financiare

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

### 3.10. Kapitulli 10: Shoqëria e informacionit dhe mediat

Ky kapitull përmban 4 masa: 1 (25%) masë legjislative dhe 3 (75%) masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.10.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Shoqëria e informacionit dhe mediat – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 25% e masave, 1 masë, janë zbatuar;
- 25% e masave, 1 masë, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 50% e masave, 2 masa, përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
  - Miratimi nga Qeveria i projektligjit për komunikimet elektronike;
  - Miratimi i Strategjisë së TIK.


Siç tregojnë gjetjet e raportit, nga gjithsej katër masa, dy përballen me vonesa serioze. Konkretisht, masa për vendosjen e infrastrukturës digjitale dhe ndërlidhjen e së paku 100 shkollave me KREN dhe GEANT, e planifikuar për t’u zbatuar deri në fund të vitit, është zbatuar para afatit. Sa i përket projektligjit për komunikimet elektronike, grupi punues ka vazhduar punën në hartimin e tij dhe janë mbajtur takime të rregullta me KE dhe ekspertët e TAIEX-it. Për shkak të mungesës së buxhetit për angazhim të ekspertizës ndërkombëtare të nevojshme për hartimin e Strategjisë së TIK-ut, nuk ka pasur zhvillime dhe ky proces përballlet me vonesa serioze.

### 3.11. Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural

Ky kapitull përmban 7 masa: 5 (71.43%) masa legjislative dhe 2 (28.57%) masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.



Diagrami 3.11.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Bujqësia dhe zhvillimi rural – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:


- 28.57% e masave, 2 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 14.29% e masave, 1 masë, përballen me pak vonesa. Kjo masë është si në vijim:
  - Miratimi i UA për kriteret dhe procedurat e zbatimit për masat e programit të zhvillimit rural.
- 57.14% e masave, 4 masa, përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
  - Miratimi nga Qeveria i projektligjit për agroturizëm;
  - Miratimi nga Qeveria i projektligjit për tokën bujqësore;
  - Miratimi i UA për sistemin e informacionit për çmimet e tregut;
  - Miratimi i UA për kontabilitetin në fermë.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, në këtë kapitull përgjithësisht shumë masa përballen me vonesa serioze. Përveç dy masave që janë në zbatim e sipër, pa vonesa, të gjitha masat e tjera përballen me vonesa serioze. Këto masa parashohin miratimin e legjislacionit primar e atij zbatues. Më tej, ka pak vonesa në miratimin e UA që lidhet me zbatimin e Programit të Zhvillimit Rural. Kështu, në tremujorin e fundit duhet të intensifikohet puna në zbatim në këtë kapitull, pasi që janë masa që ndikojnë drejtpërdrejt në reformimin e këtij kapitulli.

### 3.12. Kapitulli 12: Politikat e sigurisë së ushqimit, të veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë

Ky kapitull përmban 12 masa: 3 (25%) masa legjislative dhe 9 (75%) masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.12.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Politikat e sigurisë së ushqimit, të veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 41.67% e masave, 5 masa, janë zbatuar;
- 16.67% e masave, 2 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 25% e masave, 3 masa, përballen me pak vonesa. Këto masa janë si në vijim:
  - Miratimi i UA për luftimin e sëmundjes infektive zoonotike -tërbimi;
  - Miratimi i UA për luftimin e sëmundjes zoonotike të shpezëve-gripi i shpezëve;
  - Miratimi i koncept dokumentit për sëmundjet e kafshëve;
- 16.67% e masave, 2 masa, përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
  - Miratimi nga Qeveria i projektligjit për veterinarinë;
  - Miratimi i planit për avancimin e ndërmarrjeve agro-ushqimore.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, në këtë kapitull përgjithësisht ka vonesa në zbatim, pasi që janë zbatuar më pak se gjysma e reformave të planifikuara. Përveç pesë masave të zbatuara, përkatësisht miratimit të legjislacionit sekondar dhe

politikave për përmirësimin e shëndetit të kafshëve e të bimëve, ka vonesa serioze në hartimin e legjislacionit bazë për veterinarinë dhe të politikave për avancimin e ndërmarrjeve agro-ushqimore. Më tej, ka pak vonesa në hartimin e akteve nënligjore dhe politikave për sëmundjet e kafshëve. Kështu, në tremujorin e fundit duhet të intensifikohet puna në zbatim në këtë kapitull, pasi që janë masa që ndikojnë drejtpërdrejt në reformimin e këtij kapitulli.

### 3.13. Kapitulli 13: Peshkataria

Ky kapitull përmban 3 masa: 1 masë legjislative (33.33%) dhe 2 masa zbatuese (66.67%); asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.13.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Peshkataria – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:


- 33.33% e masave, 1 masë, janë zbatuar;
- 66.67% e masave, 2 masa, përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
  - Miratimi nga Qeveria i projektligjit për peshkatarinë dhe akua-kulturën;
  - Inventarizimi i resurseve peshkore në pellgjet ujore.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, në këtë kapitull përgjithësisht ka vonesa të konsiderueshme në zbatim, pasi që deri tani është zbatuar vetëm një nga tri reformat e planifikuara. Konkretisht, është miratuar koncepti i dokumentit për peshkatarinë dhe akua-kulturën, ndërsa ka vonesa serioze në hartimin e projektligjit për peshkatarinë, që paraqet bazën legjislative në këtë fushë, dhe në krijimin e një inventari të resurseve peshkore. Kështu, në tremujorin e fundit duhet të intensifikohet puna në zbatim në këtë kapitull, pasi që janë masa që ndikojnë drejtpërdrejt në reformimin e këtij kapitulli.

### 3.14. Kapitulli 14: Politikat e transportit

Ky kapitull përmban 11 masa: 9 (81,81%) masa legjislative dhe 2 (18,18%) masa zbatuese.

Diagrami 3.14.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Politikat e transportit – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 18,18% e masave, 2 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 18,18% e masave, 2 masa, përballen me pak vonesa. Këto masa janë si në vijim:
  - Miratimi i rregullores për specifikimet teknike për interoperabilitet në lidhje me sigurinë në tunelet hekurudhore (STI SRT);
  - Miratimi i rregullores për autorizim të nënsistemeve strukturore;
- 63,64% e masave, 7 masa, përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
  - Miratimi nga Qeveria i projektligjit për automjetet;
  - Miratimi nga Qeveria i projektligjit për hekurudha;
  - Miratimi nga Qeveria i projektligjit për transportin rrugor;
  - Miratimi nga Qeveria i projektligjit për transportin e mallrave të rrezikshme;

- *Miratimi nga Qeveria i projektligjit për siguri hekurudhore;*
- *Miratimi i Rregullores për regjistrimin e infrastrukturës (plotësim-ndryshim);*
- *Miratimi i planit të veprimit të Strategjisë së ITS.*

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (11), 1 masë legjislative (9.09%) ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.14.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Politikat e transportit – masat e planifikuara për tremujorin e tretë




Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar akoma nuk është zbatuar, pra përballet me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, nga 11 masa të planifikuara në këtë kapitull 7 prej tyre (6 masa legjislative dhe 1 masë zbatuese) përballen me vonesa serioze. Vonesa serioze ka në hartimin e projektligjit për transportin e mallrave të rrezikshme, pasi që ende nuk është formuar grupi punues. Më tej, rregullorja për regjistrim të infrastrukturës (plotësim-ndryshim) nuk është miratuar në mungesë të Bordit të ARH-së. Kësisoj, në tremujorin e mbetur duhet të intensifikohet puna për miratimin e projektligjit për automjete dhe atij për siguri hekurudhore, si dhe të rregullores për regjistrim të infrastrukturës. Këto masa ndikojnë drejtpërdrejt në reformimin e këtij sektori.

### 3.15. Kapitulli 15: Energjia

Ky kapitull përmban 15 masa: 6 (40%) masë legjislative dhe 9 (60%) masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.15.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Energjia – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 13.33% e masave, 2 masa, janë zbatuar;
- 26.67% e masave, 4 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 20% e masave, 3 masa, përballen me pak vonesa. Këto masa janë si në vijim:
  - *Miratimi i UA për caqet dhe trajektoren kombëtare për energjinë nga burimet e ripërtëritshme;*
  - *Miratimi i UA për dizajnimin dhe përcaktimin e procedurës së procesit konkurrues të tenderimit;*
  - *Zbatimi i masave të eficiencës së energjisë në ndërtesat publike në nivelin komunal: 8 objekte shkollore në 4 Komuna (Prishtinë, Gjilan, Gjakovë dhe Ferizaj);*
- 40% e masave, 6 masa, përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
  - *Miratimi nga Qeveria i projektligjit për energji;*
  - *Miratimi nga Qeveria i projektligjit për energjinë elektrike;*
  - *Miratimi nga Qeveria i projektligjit për rregullatorin e energjisë;*
  - *Miratimi nga Qeveria i projektligjit për eficiencën e energjisë;*
  - *Miratimi i Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë i Republikës së Kosovës 2024-2030;*


- Zbatimi i masave të efikasitetit të energjisë në 29 ndërtesa shumëbanesore sociale e shtëpi individuale.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, deri në fund të periudhës raportuese në këtë kapitull janë zbatuar vetëm dy masa: janë definuar lokacionet për ndërtim të centraleve të BRE-ve, si dhe ka përfunduar studimi mbi modelet e financimit të masave të efikasitetit të energjisë në sektorin privat dhe atij rezidencial. Në anën tjetër, 6 masa (4 masa legjislative dhe 2 masa zbatuese) përballen me vonesa serioze. Sa i përket projektligjit për energjinë dhe atij për energjinë elektrike, kanë përfunduar konsultimet paraprake dhe ato publike, por Qeveria akoma nuk i ka miratuar projektligjet. Vonesa serioze ka edhe në finalizimin e projektligjit për efikasitetin e energjisë dhe atij për rregullatorin e energjisë. Procesi i zbatimit të masave të efikasitetit të energjisë në 29 ndërtesa shumë-banesore sociale dhe shtëpi individuale është bllokuar për shkak të ankesave të operatorëve ekonomik pranë OSHP-së dhe vonesave të tij për të vendosur mbi to.

### 3.16. Kapitulli 16: Tatimet

Ky kapitull përmban 3 masa, të gjitha zbatuese ; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.16.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Tatimet – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 33.33% e masave, 1 masë, është zbatuar;
- 66.67% e masave, 2 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, gjendja në këtë kapitull është relativisht e mirë, pasi që një masë është zbatuar para afatit të planifikuar dhe masat e tjera janë në zbatim e sipër, pa vonesa.


### 3.17. Kapitulli 17: Politikat ekonomike dhe monetare

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

### 3.18. Kapitulli 18: Statistikat

Ky kapitull përmban 5 masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.18.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Statistikat – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 20% e masave, 1 masë, janë zbatuar;
- 60% e masave, 3 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 20% e masave, 1 masë, përballen me pak vonesa. Kjo masë është si në vijim:
  - Zhvillimi i statistikave të tregut të punës në kuadër të Anketës së Strukturës së të Ardhurave.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky kapitull nuk përballlet me vonesa serioze. Rëndësi dhe kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet zbatimit të masës për zhvillimin e statistikave të tregut të punës.

### 3.19. Kapitulli 19: Politikat sociale dhe punësimi

Ky kapitull përmban 4 masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.19.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Politikat sociale dhe punësimi – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 4 masa të planifikuara janë në zbatim e sipër, pa vonesa.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky kapitull nuk përballlet me vonesa.

### 3.20. Kapitulli 20: Politikat e ndërmarrjeve dhe ato të industrisë

Ky kapitull përmban 2 masa zbatuese.

Diagrami 3.20.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Politikat e ndërmarrjeve dhe ato të industrisë – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 50% e masave, 1 masë, është zbatuar;
- 50% e masave, 1 masë, përballen me vonesa serioze. Kjo masë është si në vijim:
  - Themelimi i Agjencisë për Inovacion dhe Mbështetjen e Bizneseve.

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (2), 1 (50%) prej tyre ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.20.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Politikat e ndërmarrjeve dhe ato të industrisë – masat e planifikuara për tremujorin e tretë



Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar akoma nuk është zbatuar, pra përballlet me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, masa e planifikuar për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, e cila përballlet me vonesa serioze, është themelimi i Agjencisë për Inovacion dhe Mbështetjen e Bizneseve. Kjo ka ndodhur për shkak të dërgimit të ligjit përkatës në Gjykatën kushtetuese për vlerësim të kushtetutshmërisë.

### 3.21. Kapitulli 21: Rrjetet trans-evropiane

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.


### 3.22. Kapitulli 22: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

### 3.23. Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Ky kapitull përmban 95 masa: 24 (25%) masa legjislative dhe 71 (75%) masa zbatuese.

Diagrami 3.23.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar - shtator 2024: Gjyqësori dhe të drejtat themelore – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 28.42 % e masave, 27 masa, janë zbatuar;
- 55.79 % e masave, 53 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 1.05 % e masave, 1 masë, përballen me pak vonesa. Kjo masa është si në vijim:
  - Rekrutimi i shtatë (7) zyrtarëve të ndërmjetësimit në prokuroritë themelore.
- 14.74 % e masave, 14 masa, përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
  - Miratimi nga Qeveria i projektligjit për drejtën në gjykim brenda kohës së arsyeshme;
  - Miratimi nga Qeveria i projektligjit për përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve (plotësim-ndryshim);
  - Miratimi i UA (masë afirmative) për rritjen e numrit të grave në pozita vendimmarrëse - niveli ekzekutiv;
  - Miratimi i UA (masë afirmative) për Regjistrimin e Pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve;
  - Miratimi i Strategjisë dhe PV për Sundimin e Ligjit;
  - Miratimi i Strategjisë dhe PV kundër Korrupsionit;
  - Miratimi i PV të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGJ) 2024-2026;
  - Miratimi i Strategjisë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2024-2029;
  - Miratimi i koncept dokumenti për trashëgiminë kulturore;
  - Emërimi i një (1) anëtari të KGjK-së.
  - Rekrutimi i trembëdhjetë (13) zyrtarëve të rinj në APK;
  - Rekrutimi i dy (2) zyrtarëve të TI-së në APK;
  - Zhvillimi i platformës elektronike për raportim të korrupsionit 'Kosova pa Korrupsion';
  - Monitorimi i zbatimit të veprimeve nga Strategjia dhe PV kundër Korrupsionit.

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (95), 14 (14.74%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë: 7 masa legjislative dhe 7 masa zbatuese.

Diagrami 3.23.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar - shtator 2024: Gjyqësori dhe të drejtat themelore – masat e planifikuara për tremujorin e tretë



Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 57.14 % e masave, 8 masa, janë zbatuar;
- 42.86 % e masave, 6 masa, akoma nuk janë zbatuar, pra përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, në këtë kapitull ka vonesa serioze në zbatim, sidomos të masave të planifikuara për t'u zbatuar nga tremujori i dytë deri në fund të vitit. Projektligji për të drejtën për gjykim brenda kohës së arsyeshme dhe ai për përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, janë në procedurë të hartimit dhe përballen me vonesa për shkak të kompleksitetit. Më tej, miratimi i aktit nënligjor për zbatimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor dhe i masës afirmative për rritjen e numrit të grave në pozita vendimmarrëse (në nivelin ekzekutiv) përballen me vonesa për të njëjtën arsye.


Sa i përket zhvillimit të politikave, akoma nuk janë miratuar pesë dokumente politikash: Strategjia dhe PV për Sundimin e Ligjit, Strategjia dhe PV kundër Korrupsionit, Plani Kombëtar për Barazi Gjinore 2024-2026, Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2024-2029 dhe Koncept dokumenti për trashëgimi kulturore.

Sa i përket avancimit të kapaciteteve në sistemin gjyqësor dhe atij prokurorial, mbetet sfiduese emërimi i një anëtari të KGJK-së dhe rekrutimi i shtatë zyrtarëve të ndërmjetësimit në prokuroritë themelore, kjo e fundit për shkak se Qeveria as këtë vit nuk e ka miratuar buxhetin e kërkuar nga KPK për këto pozita. Sfiduese mbetet edhe rekrutimi i trembëdhjetë (13) zyrtarëve dhe dy (2) zyrtarëve të IT-së në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe zhvillimi i platformës elektronike për raportim të korrupsionit 'Kosova pa Korrupsion' dhe monitorimi i zbatimit të veprimeve nga Strategjia dhe PV kundër Korrupsionit.

### 3.24. Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria

Ky kapitull përmban 23 masa: 7 (30.43%) masa legjislative dhe 16 (69.57%) masa zbatuese.

Diagrami 3.24.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar - shtator 2024: Drejtësia, liria dhe siguria – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 39.13% e masave, 9 masa, janë zbatuar;
- 34.78% e masave, 8 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 13.04% e masave, 3 masa, përballen me pak vonesa. Këto masa janë si në vijim:
  - Miratimi nga Qeveria i projektligjit për plotësim-ndryshimin e ligjit për armë;
  - Hartimi i PSO për shkatërrimin e drogave;
  - Zbatimi i udhërrëfyesit për armë të vogla dhe të lehta;
- 13.04% e masave, 3 masa, përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
  - Nënshkrimi i Marrëveshjes për bashkëpunim juridik me Francën;

- Miratimi i rregullores për integrimin e të huajve (plotësim-ndryshim);
- Rishikimi i Planit të reagimit emergjent.

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (23), 3 masa legislative (13.04%) ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.24.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar - shtator 2024: Drejtësia, liria dhe siguria – masat e planifikuara për tremujorin e tretë



Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 33.33% e masave, 1 masë, është zbatuar;
- 66.67% e masave, 2 masa, akoma nuk janë zbatuar, pra përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, në këtë kapitull janë arritur përparime të rëndësishme në zbatimin e reformave. Sa i përket kornizës ligjore, më 13 mars 2024 Qeveria ka miratuar projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për të Huajt. Më tej, në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar në çështje penale dhe civile më 24 shtator 2024 janë nënshkruar tri marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe Suedisë: Marrëveshja për Ekstradim, Marrëveshja për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale dhe Marrëveshja për Transferimin e Personave të Dënuar.

Sa u përket politikave, deri në fund të periudhës raportuese Qeveria ka miratuar tre dokumente politikash: Strategjinë për kontrollin e armëve të vogla, të lehta dhe eksplozivëve 2024-2028 (më 5 mars 2024) Strategjinë kundër Narkotikëve (më 28 qershor 2024), dhe PV të Strategjisë për Migrim (më 13 qershor 2024).

Në mesin e masave që përballen me vonesa bën pjesë edhe nënshkrimi i pakos së marrëveshjes për bashkëpunim juridik me Francën, e planifikuar për deri në fund të shtatorit. Kjo pako, e cila përfshin dy marrëveshje, atë për ekstradim dhe atë për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale, më 13 qershor 2024 është përcjellë nga Ambasada e Francës në Kosovë drejt Kabinetit të Qeverisë. Pas verifikimit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, kjo e fundit ka ofruar komente në lidhje me draft-marrëveshjet dhe është në pritje të nënshkrimit të tyre.

Në fushën e azilit, akoma nuk është zbatuar masa për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Integrimin e të Huajve, gjithashtu e planifikuar për t'u zbatuar deri në fund të shtatorit. Në këtë drejtim, është hartuar një analizë e përbashkët mbi pikat e rregullores që duhet të amendamentohen, ndërsa hartimi i saj pritet të fillojë pas miratimit të Ligjit për të Huajt nga Kuvendi. Më tej, vonesa ka edhe në rishikimin e Planit të Reagimit Emergjent, masë kjo e planifikuar për t'u zbatuar deri në fund të qershorit. Grupi punues ka përgatitur një draft dhe është mbajtur një ushtrim simulues në tryezë, për testimin e projekt-planit. Pas kësaj, ekspertë nga FRONTX dhe EUAA, si pjesëmarrës në ushtrim, janë zotuar të dërgojnë rekomandime të mëtejshme deri në fund të tetorit apo fillim të nëntorit. Ky plan do të finalizohet pas përfshirjes së këtyre rekomandimeve.

### 3.25. Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimet shkencore

Ky kapitull përmban 4 masa: 2 (50%) masa legislative dhe 2 (50%) masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.



Diagrami 3.25.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Shkenca dhe kërkimet shkencore – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 75% e masave, 3 masa, janë zbatuar;
- 25% e masave, 1 masë, përballen me vonesa serioze. Kjo masë është si në vijim:
  - *Miratimi nga Qeveria i projektligjit për veprimtari kërkimore shkencore, inovacion dhe transfer të dijes dhe teknologjisë.*

Siç tregojnë gjetjet e raportit, në këtë kapitull ka vonesa serioze në miratimin e projektligjit për veprimtari kërkimore shkencore, inovacion dhe transfer të dijes dhe teknologjisë, e cila masë nuk do të arrijë të zbatohen brenda vitit.

### 3.26. Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura

Ky kapitull përmban 10 masa: 3 (30%) masa legislative dhe 7 (70%) masa zbatuese.

Diagrami 3.26.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Arsimi dhe kultura – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 20% e masave, 2 masa, janë zbatuar;
- 40% e masave, 4 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 30% e masave, 3 masa, përballen me pak vonesa. Këto masa janë si në vijim:
  - *Miratimi i UA për koordinimin ndër sektorial për zhvillimin e edukimit në fëmijërinë e hershme;*
  - *Rekrutimi i më paku njëzet (20) inspektorë të rinj të arsimit;*
  - *Rekrutimi i të paktën 100 asistentëve për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta.*
- 10% e masave, 1 masë, përballen me vonesa serioze. Kjo masë është si në vijim:
  - *Miratimi i Kornizës Kurrikulare për AAP.*

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (10), 1 masë zbatuese (10%) ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.26.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Arsimi dhe kultura – masat e planifikuara për tremujorin e tretë




Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar akoma nuk është zbatuar, pra përballet me vonesa serioze.

*Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky kapitull në këtë kapitull përgjithësisht nuk ka vonesa serioze, me përjashtim të miratimit të Kornizës Kurrikulare për AAP, e cila është dashur të miratohej në shtator.*

### 3.27. Kapitulli 27: Mjedisi

Ky kapitull përmban 16 masa: 5 (31.25%) masë legislative dhe 11 (68.75%) masa zbatuese.

Diagrami 3.27.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Mjedisi – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 31.25% e masave, 5 masa, janë zbatuar;
- 18.75% e masave, 3 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 6.25% e masave, 1 masë, përballen me pak vonesa. Kjo masë është si në vijim:
  - *Zhvillimi i aplikacionit për raportim online për regjistrin e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve;*
- 43.75% e masave, 7 masa, përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
  - *Miratimi nga Qeveria i projektligjit për mbrojtjen e mjedisit;*
  - *Miratimi nga Qeveria i projektligjit për mbrojtjen e natyrës;*
  - *Miratimi nga Qeveria i projektligjit për inspektimin në fushën e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe banimit;*
  - *Miratimi i UA për mekanizmin e përcjelljes së emisioneve të gazrave serrë (plotësim-ndryshim);*
  - *Miratimi i strategjisë për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm 2025-2034 dhe PV;*
  - *Miratimi i strategjisë afatgjate e dekarbonizimit;*
  - *Miratimi i Strategjisë për menaxhimin e integruar të mbeturinave dhe plani i veprimit 2024-2026.*

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (16), 6 (37.5%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë: 1 masë legislative dhe 5 masa zbatuese.

Diagrami 3.27.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Mjedisi – masat e planifikuara për tremujorin e tretë



Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 50% e masave, 3 masa, janë zbatuar;
- 50% e masave, 3 masa, akoma nuk janë zbatuar, pra përballen me vonesa serioze.


*Siç tregojnë gjetjet e raportit, në këtë kapitull 7 masa (4 masa legislative dhe 3 masa zbatuese) përballen me vonesa serioze. Gjatë periudhës janar-shtator Qeveria ka miratuar Planin për Menaxhimin e Pellgut të Lumit Drini i Bardhë dhe projektligjin për menaxhimin e resurseve ujore. Gjithashtu janë finalizuar hartat e rrezikut nga përmbytjet dhe*

ato të rrezikshmërisë nga përmbytjet. Në anën tjetër, ka vonesa serioze në miratimin e tri projektligjeve (për mbrojtjen e mjedisit; për mbrojtjen e natyrës; dhe për inspektimin në fushën e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe banimit). Në tremujorin e fundit të vitit duhet punuar në miratimin e UA për mekanizmin për përcjelljen e emisioneve të gazrave serrë; si dhe të strategjisë dhe PV për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm 2025-2034 dhe strategjisë afatgjate të dekarbonizimit.

### 3.28. Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit

Ky kapitull përmban 7 masa: 5 (71.42%) masa legislative dhe 2 (28.57%) masa zbatuese.

Diagrami 3.28.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit publik – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 7 masa të planifikuara përballesh me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:

- Miratimi nga Qeveria i projektligjit për pajisje dhe produktet medicinale;
- Miratimi nga Qeveria i projektligjit për kontrollin e duhanit;
- Miratimi i UA mbi kërkesat e përcaktuara në relacion me komunikimin tregtar përfshirë reklamimin apo marketingun;
- Miratimi i UA për kriteret, procedurat, masat e biosigurisë dhe biosigurimit për transportin e mostrave për qëllime diagnostike të sëmundjeve ngjitëse;
- Miratimi i UA për ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale për rastet e mundshme, të dyshimta dhe të konfirmuara nga sëmundjet ngjitëse dhe çështjet e veçanta shëndetësore;
- Miratimi i koncept dokumentit për transplantim të organeve;
- Miratimi i planit strategjik për kontrollin e kancerit.

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (7), 6 (85.71%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë: 4 masa legislative dhe 2 masa zbatuese.

Diagrami 3.28.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit publik – masat e planifikuara për tremujorin e tretë




Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 6 masat e planifikuara akoma nuk janë zbatuar, pra përballesh me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky kapitull karakterizohet me vonesa shumë serioze, dhe pothuajse të gjitha masat e planifikuara kërkojnë vëmendje të veçantë gjatë periudhës në vijim.

### 3.29. Kapitulli 29: Unioni Doganor

Ky kapitull përmban 3 masa zbatuese.

Diagrami 3.29.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Unioni doganor – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 33.34% e masave, 1 masë, është zbatuar;
- 33.33% e masave, 1 masë, është në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 33.33% e masave, 1 masë, përballesh me vonesa serioze. Kjo masë është si në vijim:
  - Rekrutimi i zyrtarëve të rinj doganorë.

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (3), 1 masë (33.33%) ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.29.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Unioni doganor – masat e planifikuara për tremujorin e tretë



Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar akoma nuk është zbatuar, pra përballesh me vonesa serioze.

*Siç tregojnë gjetjet e raportit, masa e planifikuar për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, e cila nuk është zbatuar, është rekrutimi i zyrtarëve të rinj doganorë. Lidhur me këtë, ndonëse janë përfunduar procedurat e rekrutimit, zyrtarët e përzgjedhur nuk kanë filluar punën brenda afatit të planifikuar.*

### 3.30. Kapitulli 30: Marrëdhëniet me jashtë

Ky kapitull përmban 2 masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.30.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Marrëdhëniet me jashtë – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 2 masa të planifikuara janë në zbatim e sipër, pa vonesa.

*Siç tregojnë gjetjet e raportit, të gjitha masat e këtij kapitulli janë planifikuar të zbatohen deri në fund të vitit dhe janë duke u zbatuar pa vonesa.*

### 3.31. Kapitulli 31: Politika e jashtme, e sigurisë dhe ajo e mbrojtjes

Ky kapitull përmban 4 masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 1.1.2.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar - shtator 2024 Politika e jashtme, e sigurisë dhe ajo e mbrojtjes – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 4 masa të planifikuara janë në zbatim e sipër, pa vonesa.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, masat e planifikuara në këtë kapitull janë duke u zbatuar pa vonesa. Sa i përket pjesëmarrjes së shërbyesve civilë në trajnime në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë, kjo është në zbatim e sipër. Më tej, zyrtarë të Departamentit të MPJD-së për Evropë dhe BE kanë zhvilluar një sërë takimesh me përfaqësues të vendeve të BE-së si dhe DP NEAR në kuadër të lobimit për anëtarësim në organizata shumëpalëshe. MPJD gjithashtu ka marrë pjesë në takimin e organizuar nga EEAS me Drejtorët Politikë të MPJ-ve të gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor.

### 3.32. Kapitulli 32: Kontrolli financiar

Ky kapitull përmban 4 masa: 1 (25%) mase legislative dhe 3 (75%) masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.32.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2024: Kontrolli financiar – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 75% e masave, 3 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 25% e masave, 1 masë, përballen me vonesa serioze. Kjo masë është si në vijim:
  - Miratimi nga Qeveria i projektligjit për auditorin e përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës (plotësim-ndryshim).

Siç tregojnë gjetjet e raportit, masa e këtij kapitulli, e planifikuar për t'u zbatuar deri në fund të vitit, që po përballlet me vonesa është miratimi i projektligjit për auditorin e përgjithshëm dhe zyrën kombëtare të auditimit (plotësim-ndryshim). Është hartuar një draft fillestar, por akoma ka nevojë për përmirësime.

### 3.33. Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe ato buxhetore

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

Shtojcë: Pasqyrë e zbatimit të PKIE gjatë vitit 2024 - gjendja në fund të tremujorit të tretë

MASAT LEGJISLATIVE

Nr.	Dispozitat e MSA-së	Aktet kombëtarë që do të harmonizohen	Aktet e acquis-së së BE-së që do të transpozohen	Institucioni përgjegjës	Afatet	Gjendja e zbatimit
<b>1. BLOKU I: KRITERET POLITIKE</b>						
<b>1.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit</b>						
<b>1.1.2. Administrata publike</b>						
1.1.2.	<u>Legjislacioni kornizë</u>					
1.1.2.1.	Neni 120	Projektligji për plotësim-ndryshim të ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimi i tyre me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, faza e tretë, i miratuar		MPB	K4 2024	Vonesa serioze
1.1.2.2.	Neni 120	Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, i miratuar		MPB	K4 2024	Vonesa serioze
1.1.2.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>					
1.1.2.3.	Neni 120	Rregullorja për praninë në shërbimin civil, e miratuar		MPB	K4 2024	E zbatuar
1.1.2.4.	Neni 120	Rregullorja për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil, e miratuar		MPB	K4 2024	E zbatuar
1.1.2.5.	Neni 120	Rregullorja për transferimin në shërbimin civil, e miratuar		MPB	K4 2024	E zbatuar
1.1.2.6.	Neni 120	UA për zbatimin e Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i miratuar		MAPL	K4 2024	Vonesa serioze
1.1.2.7.	Neni 120	UA për zbatimin e Ligjit për Shqyrtim Administrativ të Akteve, i miratuar		MAPL	K4 2024	Vonesa serioze
<b>3. BLOKU III: STANDARDET EVROPIANE – PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË</b>						
<b>3.1. Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave</b>						
3.1.	<u>Legjislacioni kornizë</u>					
3.1.1.	Nenet 20, 80 dhe 74 pika 3	Projektligji për inspektimin e përputhshmërisë së produkteve, i miratuar	Rregullorja (BE) 2019/1020	MINT	K4 2024	Pak vonesa
3.1.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>					
3.1.2.	Nenet 20, 80 dhe 74 pika 3	UA për detyrimet e prodhuesve dhe shpërndarësve për njoftim, i miratuar		MINT	K4 2024	Në zbatim e sipër, pa vonesa
3.1.3.	Nenet 20, 80 dhe 74 pika 3	UA për shkëmbimin e informacionit për produktet e rrezikshme në Republikën e Kosovës, i miratuar		MINT	K3 2024	Vonesa serioze
3.1.4.	Neni 20	UA për përcaktimin e rregullave për lëvizjen e lirë në treg të detergjenteve dhe substancave tension-aktive (surfaktantive), i miratuar	Rregullorja (KE) nr. 1272/2008, CLP, për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave e përzierjeve kimike që lëshohen në tregun e BE-së Rregullorja (KE) nr. 1907/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 18 dhjetor 2006, lidhur me Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (REACH), që krijon një Agjenci Evropiane të Kimikateve, që ndryshon Direktivën 1999/45/KE dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 793/93 dhe Rregulloren e Komisionit 2000/21/KE	MMPHI	K4 2024	Pak vonesa
<b>3.4. Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit</b>						
3.4.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>					

3.4.1.	Neni 89	UA për sanksionet e shënjestruara (udhëzues për zbatimin e sanksioneve nga subjektet raportuese dhe personat që kanë detyrime për raportim të drejtpërdrejtë), i miratuar	Rregullore e Këshillit (KE) nr. 2580/2001 e 27 dhjetorit 2001 mbi masat specifike kufizuese të drejtuara kundër personave dhe subjekteve të caktuara me qëllim luftimin e terrorizmit Direktiva e BE 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 20 maj 2015, për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose të financimit të terrorizmit, që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 648/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, dhe që shfuqizon Direktivën 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Direktivën e Komisionit 2006/70/KE	MFPT	K3 2024	Vonesa serioze
3.4.2.	Neni 89	UA për sanksionet e shënjestruara (udhëzues për zbatimin e sanksioneve ndaj autoriteteve shtetërore), i miratuar	Rregullore e Këshillit (KE) nr. 2580/2001 të 27 dhjetorit 2001 mbi masat specifike kufizuese të drejtuara kundër personave dhe subjekteve të caktuara me qëllim luftimin e terrorizmit Direktiva e BE 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 maj 2015, për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose të financimit të terrorizmit, që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 648/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe që shfuqizon Direktivën 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Direktivën e Komisionit 2006/70/KE	MFPT	K3 2024	Vonesa serioze
<b>3.5. Kapitulli 5: Prokurimi publik</b>						
3.5.	<u>Legjislacioni kornizë</u>					
3.5.1.	Neni 79	Projektligji për prokurimin publik (plotësim-ndryshim), i miratuar	Direktiva 2014/24/BE për prokurimin në sektorin klasik Direktiva 2014/25/BE për shërbime/ utilitete Direktiva 2009/81/KE Direktiva e Këshillit 89/665/KEE Direktiva e Këshillit 92/13/KEE	MFPT	K2 2024	Vonesa serioze
3.5.2.	Neni 79	Projektligji për partneritetin publiko-privat (plotësim-ndryshim), i miratuar	Direktiva 2014/23/BE	MFPT	K2 2024	Vonesa serioze
<b>3.6. Kapitulli 6: E drejta e kompanive</b>						
3.6.	<u>Legjislacioni kornizë</u>					
3.6.1.	Neni 51	Projektligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim (plotësim-ndryshim), i miratuar	Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, të Komitetit Ndërkombëtar të Interpretimeve për Raportim Financiar (KNIRP), si dhe interpretimet e lëshuara dhe të adoptuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe udhëzimet përkatëse të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (BSNAS)	MFPT	K4 2024	E zbatuar
3.6.2.	Neni 51	Projektligji për shoqëritë tregtare, i miratuar	Direktiva (BE) 2017/1132 Direktiva (BE) 2017/828 Direktiva (BE) 2019/1151 Direktiva 2019/2121 Direktiva (KE) 2004/109 Direktiva (BE) 2013/50	MINT	K4 2024	Në zbatim e sipër, pa vonesa
3.6.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>					
3.6.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.					
<b>3.7. Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale</b>						
3.7.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>					

3.7.1.	Nenet 77 - 78	Rregullorja për procedura, kriteret e licencimit të shoqatave për menaxhim kolektiv dhe funksionimin e tyre, e miratuar	Direktiva 2014/26/BE për menaxhimin kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta dhe licencimin shumë-territorial të të drejtave në veprat muzikore për përdorim online në tregun e brendshëm	MKRS	K1 2024	Vonesa serioze
<b>3.8. Kapitulli 8: Politikat e konkurrencës</b>						
3.8.	<u>Legjislacioni kornizë</u>					
3.8.	<b>Ndihma shtetërore</b>					
3.8.1.	Neni 74	Projektligji për ndihmën shtetërore (plotësim-ndryshim), i miratuar	Rregullorja e Këshillit (BE) 2015/1589 e datës 13 korrik 2015 që përcakton rregullat e detajuara për zbatimin e nenit 108 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian Rregullorja (BE) 2015/1588, datë 13 korrik 2015, për zbatimin e neneve 107 dhe 108 të TFBE	MFPT	K2 2024	Vonesa serioze
3.8.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>					
3.8.	<b>Ndihma shtetërore</b>					
3.8.2.	Neni 74	Rregullorja për kushtet e dhënies së ndihmës horizontale, e miratuar	Rregullorja e KE nr. 1588/2015 dhe Rregullorja e KE nr. 651/2014	MFPT	K4 2024	Në zbatim e sipër, pa vonesa
3.8.3.	Neni 74	Rregullorja për procedurat dhe format e njoftimit (plotësim-ndryshim), e miratuar	Rregullorja e Këshillit (BE) 2015/1589 e datës 13 korrik 2015 që përcakton rregullat e detajuara për zbatimin e nenit 108 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 794/2004, e 21 prillit 2004, që zbaton Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 659/1999 që definojnë rregullat detale për aplikimin e Nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian	MFPT	K4 2024	Pak vonesa
3.8.4.	Neni 74	Rregullorja për kushtet e dhënies së ndihmës sektoriale, e miratuar	Rregullorja e KE nr. 1588/2015 Rregullorja e KE nr. 651/2014 Rregullorja (BE) 2021/1237 e 23 korrikut 2021 Rregullorja (BE) 2023/1315 e 23 korrikut 2023 Komunikata nga Udhëzimet e Komisionit për ndihmën shtetërore për rjetet brezgjere 2023/KE 36/01	MFPT	K4 2024	Pak vonesa
<b>3.9. Kapitulli 9: Shërbimet financiare</b>						
3.9.	<u>Legjislacioni kornizë</u>					
3.9.1.	Neni 96	Projektligji për bankat, i miratuar		MFPT	K4 2024	E zbatuar
3.9.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>					
3.9.2.	Nenet 50, 96 aneksi 6	Rregullorja për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së likuiditetit (ILAAP), e miratuar	Direktiva e BE-së 2013/36/BE	BQK	K4 2024	Pak vonesa
3.9.3.	Nenet 50, 96 aneksi 6	Rregullorja e rishikuar për ekspozimet e mëdha të bankave, e miratuar	Direktiva 2013/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 26 qershor 2013, për qasjen në veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të kreditit dhe firmave të investimeve, që ndryshon Direktivën 2002/87/KE dhe shfuqizon Direktivat 2006/48/KE dhe 2006/49/KE Rregullorja (BE) 2019/876 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 20 maj 2019, që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 575/2013 në lidhje me raportin e levës, raportin neto të qëndrueshëm të financimit, kërkesat për fondet e veta dhe detyrimet e pranueshme, rreziku i kreditit të palës tjetër, rreziku i tregut, ekspozimet ndaj palëve qendrore, ekspozimet ndaj sipërmarrjeve të investimeve kolektive, ekspozimet e mëdha, kërkesat për raportim dhe zbulim Rregullorja (BE) 648/2012	BQK	K4 2024	Pak vonesa



			Rregullorja (BE) nr. 575/2013 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 26 qershorit 2013 mbi kërkesat e kujdesshme për institucionet e kreditit dhe firmat e investimeve dhe ndryshimin e Rregullores (BE) nr. 648/2012			
3.9.4.	Nenet 50, 96 aneksi 6	Rregullorja për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit të siguruesve, e miratuar	Direktiva Evropiane 2002/92/KE Parimet Kyçe të Sigurimeve (ICP)	BQK	K4 2024	E zbatuar
3.9.5.	Nenet 50, 96 aneksi 6	Rregullorja për menaxhimin e rrezikut operacional të siguruesve, e miratuar	Direktiva Evropiane 2002/92/KE Parimet Kyçe të Sigurimeve (ICP)	BQK	K4 2024	Në zbatim e sipër, pa vonesa
3.9.6.	Nenet 50, 96 aneksi 6	Rregullorja për persona të ndërlidhur me siguruesit, e miratuar	Direktiva Evropiane 2002/92/KE Parimet Kyçe të Sigurimeve (ICP)	BQK	K4 2024	Në zbatim e sipër, pa vonesa
3.9.7.	Nenet 50, 96 aneksi 6	Rregullorja për kërkesat e mbajtjes së rrezikut dhe mbulimit përmes risigurimit, e miratuar	Direktiva Evropiane 2002/92/KE Parimet Kyçe të Sigurimeve (ICP)	BQK	K4 2024	E zbatuar
3.9.8.	Nenet 50, 96 aneksi 6	Rregullorja për qeverisjen korporatave të siguruesve (rishikim), e miratuar	Direktiva Evropiane 2002/92/KE Parimet Kyçe të Sigurimeve (ICP)	BQK	K4 2024	Në zbatim e sipër, pa vonesa
3.9.9.	Nenet 50, 96 aneksi 7	Rregullorja për sisteme të informacionit për siguruesit, e miratuar	Direktiva Evropiane 2002/92/KE Parimet Kyçe të Sigurimeve (ICP)	BQK	K4 2024	Në zbatim e sipër, pa vonesa
<b>3.10. Kapitulli 10: Shoqëria e informacionit dhe mediat</b>						
3.10.	<u>Legjislacioni kornizë</u>					
3.10.1.	Neni 110 dhe 111	Projektligji për komunikimet elektronike, i miratuar	Direktiva (BE) 2018/1972 për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike	ME	K4 2024	Vonesa serioze
<b>3.11. Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural</b>						
3.11.	<u>Legjislacioni kornizë</u>					
3.11.1.	Neni 102	Projektligji për agroturizëm, i miratuar	Rregullorja (BE) nr. 1305/2013 e Parlamentit Evropian	MBPZHR	K4 2024	Vonesa serioze
